



KUSHTETUESJA PUBLIKON
VENDIMIN E PLOTË, HYN NË
FUQI AFATI 12-DITOR PËR
KONSTITUIMIN E KUVENDIT

IFAQE 5

GJYKATA KUSHTETUESE
USTAVNI SUD
CONSTITUTIONAL COURT

Gjykata Kushtetuese ka publikuar të mërkurën aktgjykimin e plotë rreth konstituimit të Kuvendit të Kosovës, që do të thotë se deputetët e zgjedhur duhet ta konstituojnë organin e ri ligjvënës brenda afatit të mbetur prej 12 ditëve, duke respektuar procedurën e përcaktuar me Kushtetutën e Kosovës dhe Rregulloren e Kuvendit të Kosovës. Gjykata Kushtetuese e ka bërë të qartë se Kuvendi nuk konsiderohet i konstituuar pa u zgjedhur edhe nënkryetari serb

QEVERIA NË
DETYRË, NË
SHKELJE TË
LIGJIT APO NË
MBROJTJE TË
SHTETIT?

F. 4-5



OSMANI
BISEDON ME
KOMANDANTIN E
RI TË KFOR-it
PËR “KËRCËNIMET
ME DRONË”
NGA SERBIA

F. 5



QEVERIA NDAN 8.9 MILIONË EURO
PËR 198 NDËRMARRJE MIKRO,
TË VOGLA DHE TË MESME

F. 8

RENOVA

PUTZ

Maqedoni
Xhepçisht –Tetovë
Gurëz-Ferizaj

Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289

E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA

GROUP SH.P.K.

NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE

INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Buniamini

FABRIKA E LLAQEVE

044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË

STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË

SPORT

KOSOVA DEKORON PRESIDENTIN E
FIFA-s ME MEDALJE NDERI

F. 11

Kolegji
BIZNESI

www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA

VIENNA INSURANCE GROUP

SIGMA INTERBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË

Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency

Endrit Shaqiri
+38344685122

Internet Website,
Marketing...

USHTRIA IZRAELITE I NDALON EDHE DISA ANIJE TË TJERA ME NDIHMA PËR GAZËN

GAZA, 8 TETOR - Disa anije të tjera, që po përpqeshin të dërgonin ndihma në Gazën e rrënuar nga lufta, janë ndaluar nga forcat izraelite në ujërat ndërkombëtare të mërkurën, njoftoi koalicioni Flota e Lirisë. Kjo është hera e dytë që Izraeli ndalon anije të tilla brenda kësaj jave. Koalicioni Flota e Lirisë (FFC) është rrjet ndërkombëtar i grupeve aktiviste propalestineze që organizon misione detare civile, me qëllim për ta thyer bllokadën e Izraelit ndaj Gazës dhe për të dërguar ndihma

humanitare për palestinezët në enklavë. Ministria e Jashtme e Izraelit tha në X se anijet dhe udhëtarët e tyre janë të sigurt dhe se ata janë dërguar në një port izraelit, nga pritjet të dëbohen menjëherë. “Një tjetër përpjekje e kotë për ta shkelur bllokadën detare ligjore dhe për të hyrë në një zonë lufte, përfundoi pa rezultat”, tha Ministria izraelite. Ky është incidenti i dytë i këtij lloji në ditët e fundit, pasi Izraeli kishte ndaluar rreth 40 anije dhe kishte arrestuar më shumë se 450 aktivistë në një tjetër konvoj

ndihmash, Flotës Globale Sumud, i cili gjithashtu po përpqej të dërgonte ndihma në Gazë. FFC-ja tha se forcat izraelite “kanë rrëmbyer flotën humanitare”, duke shtuar se “anijet janë ndaluar në mënyrë të paligjshme... Pjesëmarrësit - humanitarë, mjekë dhe gazetarë nga e gjithë bota - janë marrë kundër vullnetit të tyre dhe po mbahen në kushte të panjohura”. “Forcat ushtarake izraelite nuk kanë juridiksion ligjor mbi ujërat ndërkombëtare”, shtoi koalicioni. “Flota jonë nuk paraqet asnjë



rrezik”, tha ai. Anijet bartnin ndihma me vlerë mbi 110.000 dollarë. Ndihamat përfshinin ilaçe, pajisje respiratore dhe

furnizime ushqyese të destinuara për spitalet e Gazës, shtoi FFC në llogarinë e vet në Instagram.

DEKRETI I PUTINIT SHËNJESTRON ASETET E KOMPANIVE EVROPIANE QË JANË ENDE AKTIVE NË RUSI

MOSKË, 8 TETOR - Presidenti i Rusisë, Vladimir Putin, e nënshkroi një dekret javën e kaluar, i cili duket se synon asetet e kompanive të huaja që vazhdojnë të operojnë në Rusi dhe që ende nuk janë sekuestruar nga qeveria ruse. Dekreti kërkon përshejtimin e procesit të privatizimit të pronës shtetërore për të siguruar kapacitetin e mbrojtjes së vendit, por u referohet drejtpërdrejt “veprimeve armiqësore” të Shteteve të Bashkuara dhe vendeve të tjera e organizatave të lidhura me to, të cilat synojnë të vendosin “masa kufizuese kundër qytetarëve të Federatës Ruse dhe subjekteve juridike ruse”. Gjithashtu, ky dekret përcakton një procedurë të veçantë për regjistrimin, shitjen dhe transferimin e aseteve, përfshirë edhe një afat të përshejtuar, dhe e emëron bankën PSB (më parë e njohur si Promsvyazbank) si organizatoren e vetme të shitjeve të pronave. Putini e nënshkroi këtë dekret si përgjigje ndaj shqyrtimit nga BE-ja të një skeme për t’i dhënë Ukrainës miliarda dollarë në formë huaje, bazuar në asetet e ngrira ruse në



BE, të cilat janë bllokuar qëkurse Moskë e nisi pushtimin e Ukrainës në fillim të vitit 2022. Presidentja e Komisionit Evropian, Ursula von der Leyen, e përmendi idenë e një “huaje dëmshpërblimi” në Parlamentin Evropian në fillim të shtatorit. Megjë Shtetet e Bashkuara kanë lënë të kuptohet se mund të mos jenë të gatshme ta financojnë Ukrainën për kohë të gjatë për nevojat e saj për t’u mbrojtur, Bashkimi Evropian po shqyrton mënyra të ndryshme për ta mbuluar një pjesë më të madhe të kostove në vitet 2026 dhe 2027, duke hamendësuar se lufta do të vazhdojë. Von der Leyen i dha argumentet e saj para liderëve të BE-së, të cilët u takuan me presidentin ukrainas Volodymyr Zelensky në

një samit joformal në Kopenhagë, më 1 tetor, për të diskutuar për Ukrainën. Ministri e Financave të BE-së pritet të shqyrtojë më shumë hollësi rreth këtij plani kur të mblidhen në Luksemburg javën e ardhshme. Edhe pse ende nuk janë përcaktuar të gjitha mekanizmat e huaj, disa elemente tashmë janë të qarta. Asetet ruse - të ngrira që prej pushtimit të plotë në vitin 2022 - do të përdoren për lëshimin e obligacioneve. Të ardhurat nga këto obligacione do të përdoren për rindërtimin e Ukrainës në formën e një huaje dëmshpërblimi. Ukraina do të ishte e detyruar t’i kthente paratë vetëm pasi Rusia t’i ketë paguar dëmet e luftës,

sipas një rezolute të Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së. Ukraina do t’ia ripaguante BE-së huan e dëmshpërblimeve për t’i ripaguar mbajtësit e obligacioneve, dhe më pas asetet do të zhbllokoheshin. Nëse kjo skemë zbatohet, Ukraina mund t’i marrë 170 deri në 180 miliardë euro në këste gjatë viteve 2026 dhe 2027, sipas një dokumenti diskutimi të përgatitur nga Komisioni për vendet anëtare të BE-së, të cilin e ka parë Radio Evropa e Lirë (REL).

“Përgjigjia simetrike” e Kremlinit

Kremlini e ka quajtur nismën evropiane formë konfiskimi dhe ka kërcënuar me “përgjigje simetrike”. Megjithatë, ekzistojnë dallime themelore midis planit të BE-së për huan e dëmshpërblimeve dhe konfiskimit të aseteve të kompanive evropiane që vazhdojnë të operojnë në Rusi, bashkë me privatizimin e menjëhershëm të tyre. Derisa masa evropiane nuk përfshin asnjë shtetëzim të aseteve federale ruse, dekreti i Putinit duket se synon

shtetëzimin e pronave të kompanive private. Vlerësohet se rreth 800 kompani perëndimore evropiane vazhdojnë të operojnë në Rusi. Disa prej tyre përmenden në dekret, përfshirë degën ruse të Raiffeisen Bank International të Austrisë, UniCredit të Italisë dhe prodhuesin gjerman të çokollatës Ritter Sport. Rregullatorët evropianë e kanë nxitur bankën Raiffeisen që nga viti 2022 të largohet nga tregu rus, por ajo ka ngurrar të heqë dorë nga fitimet e mëdha që ka gëzuar deri vonë si një institucion financiar pothuajse monopolist, që mundëson dërgimin e pagesave nga Rusia në Evropë. Ajo gjithashtu ka hezitur ta humbasë mundësinë për ta llogaritur degën e saj ruse si humbje. Një shitje e iniciuar nga vetë banka është praktikisht e pamundur për shkak të kushteve që përcaktojnë mënyrën se si të huajt mund të shesin asetet e tyre në Rusi. Një dekret tjetër i nënshkruar nga Putini kërkon zbritje prej 50 për qind dhe një kontribut të detyrueshëm prej 10 për qind në buxhetin rus.

Nobelin për Kimi e fitojnë tre shkencëtarë për punën në kornizat metalo-organike

STOKHOLM, 8 TETOR - Çmimi Nobel për Kimi u është ndarë shkencëtarëve Susumu Kitagawa, Richard Robson dhe Omar M Yaghi për punën e tyre në kornizat metalo-organike. Puna e të tre shkencëtarëve do të mund të përdoret për t’i luftuar disa prej problemeve më të mëdha në planet, përfshirë kontrollimin e dyoksidit të karbonit, që mund të ndihmojë

në luftimin e ndryshimeve klimatike, apo edhe në zvogëlimin e ndotjes plastike, duke përdorur elementë kimikë. Të tre fituesit do të ndajnë një çmim prej 11 milionë krunave suedeze (rreth 1 milion euro). Puna e tre shkencëtarëve bazohet në atë se si mund të ndërtohen molekulat në struktura. Komiteti i Nobelit e ka quajtur punën e tyre “arkitekturë molekulare”.

Të tre burrat kanë punuar për të ndërtuar konstruksione me hapësira të mëdha mes molekulave, përmes së cilave mund të qarkullojnë gazra dhe kimikale tjera. Ato quhen korniza metalo-organike. Njoftimi është bërë nga Akademia Mbretërore e Shkencave në Suedi, në një konferencë për medie në Stokholm.

Profesori Kitagawa punon në Universitetin e Kjotos në Japoni, profesori Richard Robson në Universitetin e Melburnit në Australi dhe profesori Omar M. Yaghi në Universitetin e Kalifornisë në Shtetet e Bashkuara. Vitin e kaluar këtë çmim e kanë fituar shkencëtarët Demis Hassabis, John Jumper dhe David Baker për punën e tyre në



proteina, të cilat i ndërtojnë bloqet e jetës. Gjatë javës janë ndarë edhe çmimet Nobel për Fizikë dhe Mjekësi.

Ambasadori i BE-së: Zgjedhjet lokale janë provë për demokracinë

PRISHTINË, 8 TETOR - Ambasadori i Bashkimit Evropian në Kosovë, Aivo Orav, u ka bërë thirrje të gjithë qytetarëve me të drejtë vote, që të dalin në votime dhe t'i zgjedhin përfaqësuesit e tyre në zgjedhjet lokale të 12 tetorit. Ai ka thënë se çdo votë zgjedhore ka rëndësi në

forcimin e Kosovës si një vend demokratik, dinamik dhe shumetnik. “Me zgjedhjet lokale që mbahen këtë të diel, u bëj thirrje të gjithë votuesve me të drejtë vote, pavarësisht prej përkatësisë etnike apo preferencës partiake, të dalin në votime dhe t'i zgjedhin përfaqësuesit e tyre. Është

thelbësore që procesi i votimit të zhvillohet në mënyrë të lirë, të drejtë dhe gjithëpërfshirëse, që vullneti i votuesve të respektohet dhe rezultatet të zbatohen. Këto zgjedhje lokale janë një provë për demokracinë e Kosovës. Kalimi me sukses i kësaj prove i hap Kosovës mundësi të reja”, ka thënë Orav.



OSMANI BISEDON ME KOMANDANTIN E RI TË KFOR-it PËR “KËRCËNIMET ME DRONË” NGA SERBIA

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

Prishtinë, 8 tetor - Pas marrjes së detyrës së komandantit të KFOR-it, presidentja e Republikës së Kosovës, Vjosa Osmani, ka pritur në takim gjeneralmajor Özkan Ulutaş. Me këtë rast, presidentja Osmani e uroi për marrjen e detyrës së komandantit të KFOR-it dhe për rikthimin e tij në Kosovë, duke shprehur besimin e plotë për vazhdim të bashkëpunimit të ngushtë në funksion të përmbushjes së synimeve të përbashkëta për paqen dhe sigurinë në Kosovë dhe rajon. Në këtë frymë, ajo ritheksoi mirënjohjen e saj për angazhimin dhe përkushtimin e të gjithë ushtarakëve që shërbejnë në kuadër të KFOR-it.

Duke diskutuar për zhvillimet në fushën e sigurisë, si dhe për kërcënimet që vijnë nga Serbia, përfshirë kërcënimet me fokus të veçantë të përdorimit të dronëve, presidentja potencoi rëndësinë e bashkëpunimit të KFOR-it me institucionet tona të sigurisë me qëllim të parandalimit të taktikave destabilizuese të Serbisë.

Edhe kryeministri në detyrë, Albin Kurti, ka pritur të mërkurën në takim mirëseardhës komandantin e ri të KFOR-it në Kosovë, gjeneralmajor Ozkan Ulutas.

Diskutuan për zhvillimet aktuale, me theks mbi situatën e sigurisë dhe për rëndësinë e bashkëveprimi dhe bashkëpunimit ndërmjet institucioneve të sigurisë të vendit dhe të misionit të NATO-s në Kosovë.

Duke i uruar mirëseardhje përsëri



në Kosovë dhe duke i dëshiruar suksese në mandatin e dytë si komandant i KFOR-it, kryeministri Kurti theksoi gatishmërinë dhe angazhimin e tij dhe të qeverisë për bashkëpunim të ngushtë me KFOR-in në ruajtjen e paqes dhe sigurisë në të gjithë territorin e vendit. Zyrtarë të Kosovës thanë në fund të shtatorit se hapësira ajrore e Kosovës ishte shkelur nga dronë të dyshuar serbë. Por, as ministri i Brendshëm në detyrë, Xhelal Sveçla, e as drejtori i përgjithshëm i Policisë së Kosovës, Gazmend Hoxha, nuk kishin dhënë hollësi rreth këtyre pretendimeve, apo kur kishin ndodhur këto shkelje të dyshuara me dronë.

KFOR-i, në anën tjetër, i tha “Radios Evropa e Lirë” më 26 shtator se nuk kishte vërejtur ndonjë hyrje të dronëve nga jashtë në hapësirën ajrore të Kosovës që mund të ndikonin në sigurinë e gjithë vendit.

Misioni paqeruajtës i NATO-s, gjithashtu, shtoi se “nuk donte të spekulonte mbi raportimet për fluturimin e dronëve të paautorizuar mbi hapësirën e Kosovës”.

Osmani u ankua për “kërcënime të vazhdueshme” nga Serbia edhe në një takim me komandantin e Komandës së Forcave të Përbashkëta Aleate të NATO-s në Napoli, admiralin Stuart B. Munsch, javën e kaluar.

KFOR-i është reaguesi i tretë i sigurisë në Kosovë, pas Policisë së Kosovës dhe misionit të Bashkimit Evropian për sundim të ligjit, EULEX.

Misioni i NATO-s, veç të tjerash, është përgjegjës për sigurinë në vijën kufitare në mes të Kosovës dhe Serbisë.

Presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiq, i hodhi poshtë pretendimet e Osmanit, duke thënë se “të gjithë po përgatiten për luftë” dhe se Kosova po “përpaket ta përdorë këtë kohë para luftës” për t'i bindur shumicën e shteteve evropiane dhe vendet e NATO-s t'ia mbajnë anën Prishtinës.

Tensionet në mes të Kosovës dhe Serbisë janë të larta veçanërisht

nga fundi i vitit 2023, kur Policia e Kosovës u sulmua nga një grup serbësh të armatosur në veriun e banuar me shumicë serbe.

Një polic i Kosovës dhe tre sulmues serbë u vranë në atë sulm në fshatin Banjskë të Zveçanit, dhe përgjegjësinë për të e mori Millan Radoičiq, ish-nënkryetar i partisë më të madhe të serbëve në Kosovë, Lista Serbe.

Kosova e cilësoi sulmin terrorist dhe e fajësoi Serbinë, por Beogradi e ka mohuar të ketë pasur gisht.

NATO-ja e shtoi praninë e saj në Kosovë gjatë vitit 2023, pas rritjes së tensioneve në veriun e banuar me shumicë serbe, dhe tani ka 4 649 paqeruajtës nga 33 shtete.

Policia e Kosovës, pjesë e garës 'King Abdullah Special Operations Training Center' në Jordani

PRISHTINË, 8 TETOR - Policia e Kosovës (PK), konkretisht zyrtarë policorë të njërive speciale, po marrin pjesë në një garë ndërkombëtare të njërive elitare policore/ushtarake të shteteve të ndryshme. Këtë vit pjesëmarrëse janë 38 ekipe të shteteve të ndryshme të botës. Në këtë garë njësitet elite

policore si dhe ato ushtarake po garojnë në disa disiplina me shkallë të lartë të vështirësisë dhe taktikës, si gjuajtje me armë të llojeve të ndryshme, marshime me pesha të rënda dhe pjesë të tjera të ushtrimeve të natyrës së kësaj fushe të operimit policor/ushtarak.

Policia e Kosovës me njësinë



elite të saj po tregojnë profesionalizëm dhe rezultate pozitive në fusha të ndryshme karshi policive të shteteve të ndryshme ndërkombëtare.

Ekipi i PK-së ka arritur të futet në pjesën finale të garave 'King Challenge', ku pjesëmarrëse në këtë fazë do të jenë 15 ekipet më të suksesshme të këtij organizimi/gare.

QEVERIA NË DETYRË, NË SHKELJE TË LIGJIT APO NË MBROJTJE TË SHTETIT?

Anëtarë të qeverisë në detyrë, që njëkohësisht janë edhe deputetë të Kuvendit, kritikohen nga përfaqësuesit e shoqërisë civile për keqpërdorim të autoritetit zyrtar dhe shkelje të hapur të Ligjit për Qeverinë

PRISHTINË, 8 TETOR - Qeveria në detyrë e Kosovës kritikohet për marrje vendimesh, megjithëse ligjërisht ka kompetenca të kufizuara gjatë periudhës tranzitore. Ekspertët ligjorë paralajmërojnë se zyrtarët që mbajnë funksione të dyfishta - si ministra dhe deputetë - po shkelin Kushtetutën dhe Ligjin për Qeverinë.

Vendimet e ekzekutivit mund të kontestohen, por nuk mund të anulohen automatikisht.

Anëtarë të qeverisë në detyrë, që njëkohësisht janë edhe deputetë të Kuvendit, kritikohen nga përfaqësuesit e shoqërisë civile për keqpërdorim të autoritetit zyrtar dhe shkelje të hapur të Ligjit për Qeverinë.

Një konflikt mes ligjit dhe praktikës së politikës po trazon skenën politike dhe institucionale të Kosovës.

Gëzim Shala nga Instituti i Kosovës për Drejtësi thotë se zyrtarët që mbajnë funksione të dyfishta tejkalojnë kompetencat e tyre. “Qeveria, sipas Kushtetutës dhe Ligjit [për Qeverinë] - tanimë të konfirmuar edhe nga Gjykata Supreme - e di fare mirë që nuk mund t’i mbajë ato pozita [të ministrave dhe zëvendësministrave]. Mbajtja e tyre është kundër Kushtetutës dhe e kundërligjshme”, thotë Shala për “Radion Evropa e Lirë”. Arbërie Nagavci është një prej zyrtarëve me dy poste - ministre në detyrë e Arsimit dhe deputete e Kuvendit. Ajo thotë për “Radion Evropa e Lirë” se merr pagën vetëm si ministre dhe jo si deputete.

Zyrtarë të qeverisë në detyrë e kanë arsyetuar këtë angazhim, përfshirë edhe kryeministrin Albin Kurti, i cili ka thënë se “shteti nuk mund të ketë vakum në qeverisje - qeveria nuk mund të ketë ndalesë funksionimi”.

Qeveria e tij është në detyrë nga 23 marsi, kur ka përfunduar mandatin katërvjeçar. Kuvendi i dalë nga zgjedhjet parlamentare të 9 shkurtit nuk ka arritur të konstituohet ende, për t’i hapur rrugë formimit të Qeverisë së re.

Çfarë thotë ligji?

Ligji për Qeverinë, në nenin 26, kërkon që çdo anëtar i qeverisë që zgjidhet deputet, duhet të japë dorëheqje nga posti në ekzekutiv para certifikimit të rezultatit të zgjedhjeve. Por, edhe pas certifikimit të rezultatit të zgjedhjeve të 9 shkurtit - më 27 mars nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve - 17 anëtarë të qeverisë në detyrë, të certifikuar edhe si deputetë, vazhduan t’i ushtrojnë funksionet e tyre



ekzekutive.

Ish-ministria e Drejtësisë, Albulena Haxhiu, dhe ish-zëvendëskryeministria Emilia Rexhepi i mbajtën të dyja pozitat deri më 26 gusht, kur u votuan nënkryetare të Kuvendit. Aktualisht, 15 zyrtarë mbajnë ende funksionet ekzekutive dhe legjislative njëkohësisht.

A vihen në rrezik vendimet e marra?

Më 15 korrik Gjykata Supreme shfuqizoi një udhëzim administrativ të ministrit në detyrë të Financave, Hekuran Murati, duke konfirmuar se ushtrimi i dy funksioneve - deputet dhe ministër - është i ndaluar sipas nenit 72 të Kushtetutës.

Udhëzimi administrativ kishte të bënte me shfrytëzimin e pajisjeve fiskale.

Qeveria në detyrë e quajti “arbitrar” vendimin e Supremes, por megjithatë e zbatoi.

Gjatë ushtrimit të funksionit në detyrë, ajo mori edhe vendime të tjera dhe bëri disa emëtime drejtorësh, përfshirë në Institutin e Kosovës për Administratë Publike, Agjencinë Kosovare për Forenzikë dhe Inspektoratin e Arsimit.

Po ashtu, ekzekutivi dhe ministrat në detyrë miratuan disa rregullore, si atë për trajnimin, testimin dhe certifikimin e inspektorëve, rregulloren për procedurën e pranimin në shërbimin civil, si dhe ndryshimin e statutit të kompanisë rajonale të ujësjellësit “Mitrovica Sh.A.”.

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, gjithashtu, revokoi licencën e Shoqatës për Administrim Kolektiv të të

Drejtave të Autorit (APIK) dhe ia dha Shoqatës së Kosovës për të Drejtat e Muzikës.

Por, a mund të kontestohen emërimet dhe vendimet e ekzekutivit në detyrë, nëse Prokuroria nis hetime për përgjegjësi penale ndaj Qeverisë dhe ministrave në detyrë?

Sipas Gëzim Shalës, jodomosdoshmërisht. Ai thekson se duhet të ruhet siguria juridike, sidomos për qytetarët që mund të jenë përfshirë në këto procedura. “Për këtë arsye, nuk mund të thuhet se automatikisht bien të gjitha vendimet, përveç rasteve kur ndonjë prej tyre është potencialisht korruptiv”, shpjegon Shala.

Megjithatë, shton ai, palët që mendojnë se janë dëmtuar nga aktet nënligjore të miratuara nga Qeveria në detyrë, mund t’i drejtohen Gjykatës Supreme. Edhe vendimet që prekin raste individuale, qytetarët kanë të drejtë t’i adresojnë në gjykatat e rregullta, thotë Shala.

A ekziston baza ligjore për hetimin e përgjegjësive penale?

Përfaqësues të shoqërisë civile dhe disa ish-opozitarë thonë se ka bazë ligjore për hetimin e përgjegjësive penale të zyrtarëve nga institucionet e drejtësisë.

“Radio Evropa e Lirë” kërkoi konfirmim nga Prokuroria Speciale e Kosovës, por, deri në publikimin e këtij artikulli, nuk mori përgjigje.

Qysh në maj, Lidhja Demokratike e Kosovës - që në legjislaturën e kaluar ishte në opozitë - ka dorëzuar 17 kallëzime penale në Prokurorinë Speciale ndaj kryeministrit në detyrë, Albin

Kurti, ministrave dhe një zëvendësministreje në detyrë, të cilët janë zgjedhur edhe deputetë.

Ata u akuzuan për shkelje të Ligjit për Qeverinë dhe keqpërdorim të mundshëm të pozitës apo autoritetit zyrtar.

Këto kallëzime u dorëzuan nga deputetët e LDK-së, Doarsa Kica-Xhelili dhe Hykmete Bajrami.

Kica-Xhelili thotë se më 5 qershor Prokuroria Speciale u ka kërkuar, përmes një letre, informacione shtesë lidhur me shkeljet e pretenduara, dhe që nga ajo kohë nuk kanë pasur kontakt tjetër. “Ne e kemi shpjeguar bazën ligjore përse ata nuk kanë të drejtë të marrin vendime dhe nuk mund t’i shfrytëzojnë asetet e shtetit. Krejt çka kemi pranuar është ajo letër”, thotë Kica-Xhelili për “Radion Evropa e Lirë”. Sipas saj, mundësia për hetim penal ekziston në dy rrafshë: anëtarët e Qeverisë në detyrë që janë edhe deputetë nuk mund të marrin vendime, dhe nuk mund të shfrytëzojnë asetet e shtetit nga pozicioni ekzekutiv.

Ministria në detyrë, Nagavci, konfirmon se hetuesit i kanë kërkuar të dhëna për vendimet që ka marrë ministria që ajo udhëheq, gjatë kohës në detyrë. “Ua kemi dërguar me shkrim materialet që i kanë kërkuar. Intervistë ose ndonjë ftesë nuk ka pasur - së paku jo për mua”, thotë Nagavci.

Sipas Kodit të Procedurës Penale, prokurori ka të drejtë që brenda 30 ditësh nga dorëzimi i kallëzimit penal të kërkojë informacione shtesë për të verifikuar nëse pretendimet e përfshira janë të bazuara.

Në këtë rast, pasi prokurori ka kërkuar informacion shtesë, ai ka afat gjashtë muaj nga data e

paraqitjes së kallëzimit fillestar për të nxjerrë aktvendim për hedhjen poshtë të kallëzimit penal ose për nisjen e hetimeve. Mexhide Demolli nga Lëvizja FOL - organizatë joqeveritare që angazhohet për promovimin e transparencës dhe llogaridhënies në institucionet publike - thotë se një njoftim nga Prokuroria për të treguar nëse i ka nisur apo jo hetimet tashmë, do të ishte me interes për publikun.

“Fatkeqësisht, ka shumë zvarritje në shumë procese, dhe kjo nuk bën përjashtim. Do të kalojë kohë derisa të kemi një vendim ose një njoftim zyrtar nga Prokuroria Speciale për atë se çfarë po ndodh me këtë çështje”, thotë Demolli për “Radion Evropa e Lirë”.

Sipas Shalës, Prokuroria është brenda afateve ligjore, por nuk do të thotë se “duhet të presë ditën e fundit të afatit për të dhënë njoftimin lidhur me rastin”.

Implikimet në skenën politike

Më 12 tetor Kosova do t’i mbajë zgjedhjet për kryetarë të komunave dhe asambleistë komunalë. Aktualisht, partitë politike janë në fushatë zgjedhore.

Shala thekson se çdo vendim i Prokurorisë, çfarëdo qoftë ai, mund të ndikojë në zhvillimet politike, por kjo nuk duhet të jetë shqetësim për institucionin. “Prokurori i Shtetit, si institucion ligjzbatues, nuk duhet të marrë parasysh se si një çështje mund të ndikojë në zgjedhje ose në politikën ditore”, thotë ai.

Ngjashëm mendon analisti Imer Mushkolaj. Sipas tij, Prokuroria dhe institucionet e tjera të drejtësisë duhet të japin përgjigje sa më shpejt, veçanërisht kur vendimet ndikojnë në ekzekutiv. Megjithatë, Mushkolaj shton se në Kosovë palët politike shpesh interpretojnë vendimet e drejtësisë në mënyra të ndryshme. “Një qasje e tillë, fatkeqësisht, do të mund të vazhdonte edhe po qe se do të kishim tash një vendim ose përgjigje nga ana e Prokurorisë, sidomos kur jemi edhe më afër mbajtjes së zgjedhjeve lokale, si dhe mundësisë që të mbahen zgjedhje të tjera të parakohshme [parlamentare]”, thotë Mushkolaj.

Kosova është në pritje të publikimit të aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese, të datës 30 shtator, me të cilin ka konstatuar se seanca konstituive e Kuvendit, e nisur më 15 prill, nuk ka përfunduar dhe se ajo duhet të përfundojë brenda 12 ditësh nga hyrja në fuqi e këtij aktgjykimi.

KUSHTETUESJA PUBLIKON VENDIMIN E PLOTË, HYN NË FUQI AFATI 12-DITOR PËR KONSTITUIMIN E KUVENDIT

Gjykata Kushtetuese ka publikuar të mërkurën aktgjykimin e plotë rreth konstituimit të Kuvendit të Kosovës, që do të thotë se deputetët e zgjedhur duhet ta konstitujnë organin e ri ligjvënës brenda afatit të mbetur prej 12 ditëve, gjithnjë duke respektuar procedurën e përcaktuar me Kushtetutën e Kosovës dhe Rregulloren e Kuvendit të Kosovës. Gjykata Kushtetuese e ka bërë të qartë se Kuvendi nuk konsiderohet i konstituuar pa u zgjedhur edhe nënkryetari serb

EPOKA
ERE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 8 TETOR - Gjykata Kushtetuese e Kosovës e ka publikuar të mërkurën aktgjykimin e plotë lidhur me ankesën e dorëzuar nga Lista Serbe - partia më e madhe e serbëve në Kosovë - që ka të bëjë me konstituimin e Kuvendit. Gjykata ka bërë me dije në vendimin e publikuar ditë më parë se Kuvendi nuk është konstituuar dhe u ka dhënë 12 ditë afat deputetëve që ta finalizojnë procesin, prej ditës së publikimit të plotë të vendimit në faqen e saj. Aktgjykimi i plotë është

publikuar më 8 tetor. “Gjykata rikujton se nga dispozitat kushtetuese, të Rregullores së Kuvendit dhe praktika gjyqësore e Gjykatës, nuk rezulton ndonjë obligim i deputetëve për votimin në pako të nënkryetarëve të Kuvendit, qofshin ata që propozohen nga 3 (tre) grupet më të mëdha parlamentare apo komunitetet që nuk janë shumicë. Në këtë kontekst, duke qenë se votimi në pako nuk është shprehimisht i përcaktuar në Kushtetutë, i njëjti mund të realizohet nëse ka dakordim në mes të grupeve parlamentare apo deputetëve”, është thënë në vendimin e plotë. Gjykata ka thënë se, “bazuar në



praktikën parlamentare për zgjedhjen e nënkryetarëve nga radhët e deputetëve të komuniteteve që nuk janë shumicë që nga viti 2011, nënkryetarët nga radhët e deputetëve të komuniteteve që nuk janë shumicë, janë votuar dhe zgjedhur në pako. Kësisoj, Gjykata vlerëson që një procedurë e tillë e votimit mbetet në vullnetin e deputetëve dhe grupeve parlamentare me kushtin që të realizohet zgjedhja e anëtarëve të Kryesisë së Kuvendit”. Lista Serbe ishte ankuar pikërisht për këtë pikë të

procedurës, duke vlerësuar se mosvotimi në pako i dy nënkryetarëve nga pakicat përbënte shkelje. Emilija Rexhepi është zgjedhur nënkryetare e Kuvendit nga minoriteti joserb, ndërsa asnjëri deputet serb nuk i ka siguruar votat e nevojshme për pozitën e rezervuar për këtë minoritet, pavarësisht prej disa raundeve të votimit dhe ndryshimit të emrave të kandidatëve. Pas pranimit të ankesës, Gjykata Kushtetuese pati vendosur një masë të përkohshme, e cila ua ka ndaluar deputetëve të ndërmernin veprime drejt

formimit të qeverisë së re, meqë ka pasur dyshime për ndonjë shkelje kushtetuese. Ajo e ka bërë të qartë se Kuvendi nuk konsiderohet i konstituuar pa u zgjedhur edhe nënkryetari serb. Në aktgjykimin e plotë, Gjykata ka thënë se bazuar në Kushtetutë dhe Rregulloren e Punës së Kuvendit, nënkryetari i Kuvendit nga komuniteti serb zgjedhet me shumicën e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit, respektivisht 61 vota për, dhe propozimi bëhet me shkrim nga shumica e deputetëve nga radhët e komunitetit serb. “Nga si më sipër, Gjykata nënvizon se propozimi për nënkryetar të Kuvendit nga radhët e deputetëve të komuniteteve që nuk janë shumicë, në rastin konkret, të komunitetit serb, duhet që të bëhet nga shumica apo numri më i madh i deputetëve nga radhët e deputetëve të komunitetit serb”. Në përbërjen e Kuvendit, Lista Serbe i ka nëntë ulëse që janë të rezervuara për komunitetin serb dhe një tjetër e ka fituar Nenad Rashiq nga partia serbe Për Liri, Drejtësi dhe Mbijetesë, i cili është edhe ministër në detyrë në qeverinë e Albin Kurtit.

IKD-ja: VENDIMET E KUNDËRLIGJSHME TË QEVERISË NGREHIN DYSHIME PËR PËRGJEGJËSI PENALE

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 8 TETOR - Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD) ka reaguar ndaj vendimeve të marra më 7 tetor nga qeveria në detyrë vetëm pesë ditë para zgjedhjeve lokale. IKD-ja i ka cilësuar këto vendime, që përfshijnë ndarje fondesh për studentë dhe familje në nevojë me vlerë mbi 30 milionë euro, të kundërligjshme dhe me ndikim elektorale. “Këtu bën pjesë shtimi i një mase në kuadër të Pakos së Ringjalljes Ekonomike - Bursa e Mobilitetit për Studentë, masë e cila prek vlerën 20 milionë euro. Në të njëjtën mbledhje është marrë po ashtu vendimi për ndarjen e një shumë prej 100 eurosh, njëherësh, për studentët, kosto financiare e të cilit vendim përlllogaritet të jetë 6 milionë euro si dhe ka miratuar ndarjen e 1 milion eurove për kuponë ushqimi për familjet në nevojë. Një tjetër vendim ka të bëjë me shqyrtimin e kërkesës për shpronësim për interes publik të pronave të paluajtshme që preken nga projekti ‘Ndërtimi i kyçjes së Vitisë në autoudhën ‘Arbër Xhaferi’ (Prishtinë - Hani i Elezit)’, me vlerë rreth 3 milionë euro si dhe është miratuar Programi për mbrojtjen e konsumatorëve të cenueshëm të energjisë elektrike”, është thënë

në reagimin e IKD-së.

Sipas IKD-së, pjesëmarrja e deputetëve në vendimmarrje si anëtarë të qeverisë është në kundërshtim me Kushtetutën dhe Ligjin për Qeverinë. Po ashtu, këto vendime tejkalojnë kompetencat e një qeverie në detyrë dhe mund të përbëjnë vepër penale sipas nenit 414 të Kodit Penal të Kosovës. “Sipas aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Kushtetuta dhe Ligji për qeverinë ndalojnë që një person të jetë njëkohësisht deputet dhe anëtar i qeverisë. Nëse një ministër zgjidhet deputet, ai duhet të japë dorëheqje nga posti i ministrit para certifikimit të zgjedhjeve. Qeveria në detyrë mund të vazhdojë punën, por nuk mund të përbëhet nga persona që janë edhe deputetë. Këtë e ka konfirmuar Gjykata Supreme, e cila shpalli të paligjshëm një udhëzim administrativ të Ministrisë së Financave sepse ishte nënshkruar nga një ministër që në atë kohë ishte edhe deputet. Në rastin e djeshëm, duke vepruar si persona zyrtar dhe duke shfrytëzuar kundërligjshëm detyrën e tyre zyrtare, deputeti Kurti dhe disa nga deputetët e tjerë të Kuvendit të Kosovës, duke vepruar në cilësinë e kryeministrit në detyrë dhe ministrave në detyrë, miratuan dhe nxorën vendime, duke



tejkualuar autorizimet e tyre kushtetuese dhe ligjore. Për shkak të papajtueshmërisë ligjore dhe kushtetuese, çdo vendim i marrë nga persona që mbajnë njëkohësisht pozitën e deputetit dhe ministrit në detyrë përbën vendim të kundërligjshëm. Si rrjedhojë, e kundërligjshme është edhe vendimmarrja e djeshme”, është thënë në reagimin e IKD-së. Më tutje, IKD-ja ka kërkuar nga Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës t'i hetojë veprimet e dyshuara për keqpërdorim të pozitës zyrtare dhe fondeve publike për përfitime politike në prag të zgjedhjeve. “Përtej kësaj, vendimet e nxjerra tejkalojnë kompetencat dhe përgjegjësitë e një Qeverie në detyrë. Ligji për Qeverinë thekson se ‘Qeveria në dorëheqje kryen vetëm aktivitetet e domosdoshme dhe të planifikuara me Planin vjetor të punës së Qeverisë dhe me ligjin vjetor për buxhetin...’. Në rastin konkret, vendimet e marra nuk janë vendime të planifikuara

me Planin Vjetor të Punës si dhe nuk janë të parashikuara me ligjin vjetor për buxhetin. Kësisoj, vendimet në fjalë tejkalojnë kufizimet e një qeverie në detyrë dhe rrjedhimisht përbëjnë vendime të kundërligjshme që qeveria në detyrë nuk ka kompetencë, respektivisht të drejtë t'i merr”, thuhet në këtë reagim, duke theksuar se në anën tjetër, koha në të cilën këto vendime janë nxjerrë, vetëm pesë ditë para zgjedhjeve lokale në Kosovë, ngre dyshime për keqpërdorim të detyrës zyrtare dhe fondeve publike për qëllime elektorale, veprime këto penalisht të sanksionuara. “Neni 414 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës thekson se ‘Personi zyrtar, i cili duke shfrytëzuar detyrën apo autoritetin zyrtar i tejkalon kompetencat e tij ose nuk i përmbush detyrat zyrtare të tij me qëllim që të përfitoj çfarëdo dobie për vete ose për personin tjetër apo që t'i shkaktojë dëm personit tjetër ose që t'i shkel të drejtat e personit tjetër, dënohet me burgim prej një (1) deri në tetë (8) vjet’. Kundërligjshmëria në të cilën përfshihen vendimet e marra vetëm pesë (5) ditë para raundit të parë të zgjedhjeve lokale ngre dyshime se ato janë ndërmarrë me qëllim favorizimi politik të partisë apo kandidatëve të partisë LV që garojnë në

zgjedhjet lokale të caktuara me 12 tetor 2025. Kjo tregon se këto veprime mund të jenë bërë për të ndikuar të votuesit dhe për të sjellë më shumë vota për subjektin politik që përfaqësohet në mënyrë të kundërligjshme përmes qeverisë në detyrë”, është thënë në reagimin e IKD-së. Në këtë mënyrë, sipas IKD-së, krijohet “çfarëdo dobie” për partinë në pushtet apo kandidatët e saj që janë pjesë e garës në shumicën e komunave. “Ndërkaq, qëllimi (dashja), si element i kësaj veprë penale, vërtetohet edhe nga fakti se po vazhdohet me marrjen e vendimeve, megjithëse Gjykata Supreme ka konstatuar qartë se personat e certifikuar si deputetë nuk kanë të drejtë të marrin vendime në cilësinë e anëtarit të Qeverisë. Kështu, vendimmarrja e djeshme, në tejkallim të autorizimeve ligjore, shkeljes së procedurave dhe në prag të ditës së zgjedhjeve, ngre dyshime për përmbushje të të gjitha elementeve të veprës penale të keqpërdorimit të pozitës apo autoritetit zyrtar. Në këtë drejtim, përballë këtyre dyshimeve publike për kryerje të veprave penale, IKD-ja kërkon nga Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës që këtë përgjegjësi ta adresojë brenda kompetencave dhe përgjegjësi të tyre”, është thënë në reagimin e IKD-së.

Dhjetëra profesionistë të licencuar nga Ministria e Drejtësisë në fushën e shërbimeve sociale dhe familjare

PRISHTINË, 8 TETOR - Ushtruesi i detyrës së ministrit të Drejtësisë, Blerim Sallahu, ka ndarë të mërkurën certifikata licencimi për dhjetëra profesionistë që tashmë janë të gatshëm të ofrojnë shërbime të specializuara në mbështetje të individëve, familjeve dhe komuniteteve. Këta punonjës profesionalë, të përgatitur sipas standardeve ligjore dhe etike, përfaqësojnë një hap të rëndësishëm drejt forcimit të sistemit të mbrojtjes sociale në vend. Ministria e Drejtësisë ka njoftuar se ky proces konfirmon përkushtimin institucional për të ndërtuar një rrjet të fuqishëm profesionistësh të fushës sociale e familjare, në funksion të një shoqërie më të drejtë, më humane dhe më të përgjegjshme, ndaj kategorive në nevojë të mbështetjes sociale.



MASHTI HAP THIRRJEN PËR PROJEKTE TË VOGLA, KREATIVE DHE INOVATIVE NË FUSHËN E STEM



PRISHTINË, 8 TETOR - Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI) ka hapur thirrjen për projekte të vogla, kreative dhe inovative në fushën e Shkencës, Teknologjisë, Inxhinierisë, Matematikës dhe Arkitekturës (STEM). Kjo iniciativë synon t'i inkurajojë studentët e rinj që të zhvillojnë ide origjinale, të zbatueshme dhe me ndikim pozitiv në shoqëri dhe ambient. Thirrja është e hapur për studentët aktualë të nivelit Bachelor në fakultetet e fushave STEM, të cilët ftohen të aplikojnë në ekipe prej 3 deri në 5 anëtarë, me përbërje të përzier vajza dhe djem. Projektet duhet të jenë origjinale, kreative dhe të realizueshme, duke adresuar një problem ekzistues të shoqërisë apo ambientit. Secili projekt duhet të paraqitet së paku në shkallë modeli dhe të përshkruhet përmes një poster (maksimum 1 faqe A0) dhe një videoje 3-5 minuta që shpjegon idenë dhe zgjidhjen inovative.

Çmimet për fituesit: Vendi i parë 1 000 euro; vendi i dytë 750 euro dhe vendi i tretë 500 euro. Fituesit do të kenë gjithashtu mundësinë t'i paraqesin projektet e tyre në Konferencën STEMInists 2025; Marrin certifikata nga MASHTI; Promovohen në faqet zyrtare dhe rrjetet sociale të ministrisë. MASHTI i inkurajon të gjithë studentët e kualifikuar të aplikojnë dhe të kontribuojnë me ide që sjellin ndryshim, inovacion dhe zhvillim të qëndrueshëm në vend.

FSK-ja PAJISET ME DRONË LUFTARAKË ‘SKYDAGGER’

PRISHTINË, 8 TETOR - Kryeministri në detyrë, Albin Kurti, ka njoftuar se kontejnerët me mijëra dronë luftarakë kamikazë Skydagger kanë mbërritur të mërkurën në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës “Adem Jashari”. Ai ka thënë se dhjetëra ushtarakë të FSK-së tashmë janë trajnuar për përdorimin e tyre. “Kontrata është nënshkruar në dhjetor të vitit të kaluar me kompaninë e mirënjohur turke Baykar, që është kompani amë e prodhuesit Skydagger. Dronët Skydagger ishte planifikuar të mbërrin në janar 2026, por i morëm tre muaj më herët. Këta dronë kamikazë të njohur edhe si FpV të tipit RTF (Ready to Fly) Skydagger të prokuruar nga ne janë dronë luftarakë të pajisur me mjete shpërthyesë me qëllim goditjen e objektivave lëvizëse dhe statike të armikut”, ka shkruar Kurti në “Facebook”. Ai ka thënë se me blerjen e këtij kontingjenti të fluturakeve pa pilot, krahas TB2 Bayraktar dhe fluturakeve Puma, po vazhdojnë ta ngrehin dhe shtojnë fuqinë goditëse të ushtrisë sonë me qëllim ndërtimin e një force të aftë dhe koherente me zhvillimet e reja teknologjike dhe taktikat e luftës bashkëkohore. “Dronët u ngarkuan në kamionët multifunksional Rheinmetall 8x8 që i patëm marrë vitin e kaluar, 15 sosh gjithsej, 10 të blera nga ne dhe 5 donacion”, ka njoftuar Kurti.



ÇANTA ‘LOUIS VUITTON’, KËPUCË DHE PARFUME KONFISKOHEN NË VËRMICË NGA DOGANA



PRISHTINË, 8 TETOR - Gjatë kontrolleve rutinore në Pikëkalimin Kufitar në Vërmicë, zyrtarët doganorë kanë identifikuar dy raste të kundërvajtjeve doganore. Pas selektimit të dy automjeteve për kontroll në vijën e dytë, janë zbuluar mallra të ndryshme të padeklaruara.

Dogana njofton se në të dyja rastet palët kishin mohuar posedimin e ndonjë malli për deklarim, por gjatë kontrollit janë gjetur mallra si: pjesë të përdorura për automjete, drita të përparme, parfum, çantë dore si dhe një pako me këpucë të llojeve të ndryshme (mall stoku).

Përveç çantës së dorës, për të gjitha mallrat e tjera nuk është paraqitur faturë apo dokument përcjellës. “Të gjitha mallrat janë ndaluar përkohësisht, deri në përfundimin e procedurave të mëtejshme, ndërsa ndaj palëve janë iniciuar procedura për kundërvajtje doganore, në përputhje me ligjin në fuqi”, thuhet në njoftim.

Dogana e Kosovës u bënë thirrje të gjithë qytetarëve dhe udhëtarëve që t'i respektojnë obligimet ligjore dhe të bëjnë deklarim të saktë të mallrave gjatë kalimeve kufitare, duke shmangur pasojat ligjore dhe ndihmuar në mbrojtjen e tregut të brendshëm.

Policia në Prizren vazhdon ligjëratat edukative në shkolla

PRIZREN, 8 TETOR - Policia e Kosovës, përveç detyrave të përditshme si patrullimet dhe pikat e kontrollit, vazhdon angazhimin në edukimin dhe vetëdijesimin e të rinjve përmes ligjëratave në shkolla. Qëllimi i këtyre takimeve është informimi i nxënësve për rreziqet dhe parandalimin e veprave penale. Gjatë kësaj jave zyrtarë policorë nga stacionet e Prizrenit dhe Prizren-Veri mbajtën ligjëratat me nxënësit, ku u trajtuan tema si siguria në rrugë dhe respektimi i shumëllojshmërisë së shoqërisë, me fokus në parandalimin e ekstremizmit dhe radikalizmit të dhunshëm. Në këto aktivitete marrin pjesë edhe mësimmshënësit dhe psikologët e shkollave, duke ndarë njohuri, ide dhe mendime, me qëllim krijimin e një ambienti më të sigurt dhe të ndërgjegjshëm për të gjithë.



Afaristi Dervishaj viziton “Handikos”-in në Prishtinë, diskutohet për shkëmbimin e përvojave me Gjermaninë

PRISHTINË, 8 TETOR - Afaristi shqiptar në Gjermani, Shahin Dervishaj, ka vizituar të mërkurën organizatën “Handikos” në Prishtinë, me zyrtarë të së cilës ka diskutuar për bashkëpunimin e mëtejshëm dhe për t'i ndërmjetësuar kontaktet

me organizatat simotra në Gjermani, me synim shkëmbimin e përvojave, forcimin e kapaciteteve dhe mbështetjen e iniciativave të përbashkëta. “I nderuar ekip i HandiKOS Prishtinë, faleminderit për pritjen dhe

bisedën e ngrohtë gjatë vizitës sime. E vlerësoj shumë punën dhe angazhimin tuaj në përkrahjen e personave me aftësi të kufizuara. Siç diskutuam, mbetëm i përkushtuar për të zhvilluar bashkëpunimin tonë të

mëtejshëm dhe për të ndërmjetësuar kontaktet me organizatat simotra në Gjermani, me synim shkëmbimin e përvojave, forcimin e kapaciteteve dhe mbështetjen e iniciativave të përbashkëta”, ka shkruar Shahin Dervishaj.



KRYEZIU: RRETH 99 % E KRYETARËVE AKTUALË PRITET TË HYJNË NË BALOTAZH



PRISHTINË, 8 TETOR - Drejtori i Institutit Demokratik të Kosovës (KDI), Ismet Kryeziu, ka thënë se rreth 99 % e kryetarëve aktualë pritet të hyjnë në balotazh, e në shumicën e komunave të dalin kandidatët më të votuar. Ai ka shkruar në “Facebook” se nëse në zgjedhje duhet të ndihet një frymë zgjedhore, qoftë ajo e mbajtjes së pushtetit apo e ndryshimit dhe ardhjes në pushtet, zakonisht vërehet qartë dhe nga secili. Por, sipas tij, këtë herë fryma e rotacioneve

politike po duket se mungon. “Përveç dy a tre komunave ku ka përplasje brenda të njëjtit krah politik, nuk po shihet ndonjë energji qytetare për ndryshim të pushteteve lokale”, ka shkruar Kryeziu. Ai ka thënë se fushata po zhvillohen më shumë në nivel rutinor, me kandidatë që përsërisin qasjet e njohura dhe me votues pa ndonjë energji zgjedhore. “Prandaj, rreth 99% e kryetarëve aktualë pritet të hyjnë në balotazh, dhe në shumicën e komunave të dalin

kandidatët më të votuar. Madje edhe sfidantët kryesorë, ata që do të përballen me ta në raundin e dytë, besoj se tashmë janë të ditur në shumicën e komunave”, ka thënë ai. Sipas tij, në këto kushte gjasat janë që vetëm balotazhi të krijojë një energji të re zgjedhore, atë momentin kur fryma zgjedhore ngjallet. “Deri atëherë, gjithçka duket më shumë si një përgatitje e qetë për fazën e dytë, sesa si një garë që po frymëzon qytetarët”, ka shkruar Kryeziu.

GËRVALLA NË TAKIMIN E MINISTRAVE TË JASHTËM NË KUADËR TË PROCESIT TË BERLINIT

PRISHTINË, 8 TETOR - Zëvendëskryeministrja dhe ministrja në detyrë e Punëve të Jashtme dhe e Diasporës, Donika Gërvalla, po merr pjesë në takimin e Ministrave të Jashtëm të Procesit të Berlinit, që zhvillohet më 8 dhe 9 tetor, në Belfast të Irlandës së Veriut, me pjesëmarrjen edhe të sekretarëshes së Shtetit për Punë të Jashtme të Mbretërisë së Bashkuar, Yvette Cooper.

Takimi i Ministrave të Jashtëm në kuadër të Procesit të Berlinit bashkon ministrat e punëve të jashtme të vendeve të Ballkanit Perëndimor dhe të shteteve pjesëmarrëse në këtë proces. Në fokus të diskutimeve të këtij viti janë temat e sigurisë dhe zhvillimit rajonal si dhe domosdoshmëria e bashkëpunimit përballë sfidave dhe kërcënimeve të përbashkëta në një botë gjithnjë

e më të paqëndrueshme. Gjatë punimeve të këtij procesi, ministrja Gërvalla do të zhvillojë një sërë takimesh bilaterale me homologë dhe përfaqësues të lartë të vendeve pjesëmarrëse. Procesi i Berlinit, i nisur në vitin 2014, mbetet nisma qendrore për bashkëpunim politik, ekonomik dhe shoqëror mes vendeve të Ballkanit Perëndimor dhe partnerëve evropianë.



AGJENCIA E AKREDITIMIT FILLOI PROCESIN E MONITORIMIT PËR VITIN AKADEMIK 2025/2026



PRISHTINË, 8 TETOR - Agjencia e Kosovës për Akreditim (AKA), përmes Divizionit të Monitorimit, ka filluar zbatimin e procesit të monitorimit për vitin akademik 2025/2026. Gjatë kësaj periudhe ekipi i AKA-së do të zhvillojë vizita informuese në të gjitha institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Kosovës, me

qëllim që t'i njoftojë ato me procesin e monitorimit, në përputhje me Rregulloren e re për Monitorim, e cila ka hyrë në fuqi këtë vit. Rregullorja është dërguar më herët tek të gjitha institucionet dhe është publikuar edhe në faqen zyrtare të AKA-së. Këto takime informuese po organizohen duke u bazuar në rekomandimet e institucioneve

të arsimit të lartë, të dhëna pas vlerësimit të Divizionit të Monitorimit përmes pyetësorëve të realizuar me të gjitha institucionet që kanë kaluar procesin e monitorimit. AKA-ja ka theksuar se mbetet e përkushtuar ndaj transparencës, bashkëpunimit dhe përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë në arsimin e lartë në Kosovë.

Policia kap mbi 5 kilogramë marihuanë në Gjakovë, një i arrestuar

GJAKOVË, 8 TETOR - Drejtorja për Hetimin e Trafikimit me Narkotikë-Gjakovë pas pranimi të informacioneve se i dyshuari mashkull kosovar është duke kryer veprën penale blerje, shitje e substancës narkotike, ka ndërmarrë veprime të menjëhershme

operative dhe hetimore ,të cilat kanë rezultuar me arrestimin e një personi të dyshuar mashkull si dhe sekuestrimin e narkotikëve të llojit marihuanë. Në konsultim me prokurorin kompetent dhe me urdhër verbal për kontroll, DHTN, në bashkëveprim edhe me

stacionin policor - Gjakovë, ka realizuar kontrollin në pronën e të dyshuarit mashkull kosovar ku janë gjetur dhe janë sekuestruar provat material, si: substancë e dyshuar narkotike e llojit mariuhanë me peshë totale 5043 gramë (5 kg e 43 gramë), 40 euro dhe një telefon

mobil. Lidhur me rastin, pas konsultimeve me prokurorin kompetent, është proceduar rasti ndaj të dyshuarit të lartcekur për veprën penale ‘blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paaautorizuar e narkotikëve, substancave



psikotrope dhe analoge”, ndërsa personi i dyshuar është ndaluar për 48 orë.

BANKA BOTËRORE: EKONOMIA E KOSOVËS U NGADALËSUA NË 3.6 PËR QIND NË TREMUJORIN E PARË TË VITIT 2025

PRISHTINË, 8 TETOR - Raporti i Bankës Botërore për rajonin e Ballkanit ka paraqitur të dhëna edhe për ekonominë e Kosovës. Në raport thuhet se në vitin 2025 presionet nga inflacioni janë rikthyer, të nxitura nga çmimet më të larta të energjisë dhe ushqimeve, duke ulur kështu të ardhurat reale të disponueshme.

Në raport thuhet se pas një rritjeje prej 4.4-përqindësh në vitin 2024, ekonomia e Kosovës u ngadalësua në 3.6 për qind në tremujorin e parë të vitit 2025 për shkak të uljes së konsumit të familjeve dhe dobësimit të kërkesës së jashtme.

Më tutje thuhet se vonesat e zgjatura në formimin e një qeverie të re mund të ndikojnë negativisht në investime dhe ta ngadalësojnë përparimin në reformat strukturore.

Në raport, po ashtu, thuhet se

pagat reale u rritën 10.3 për qind në vitin 2024, të mbështetura nga një rritje e pagës minimale, por punësimi formal u rrit vetëm në mënyrë modeste, me një mesatare prej 1.4-përqindësh në gjysmën e parë të vitit 2025.

Edhe investimet u forcuan, me bruto të kapitalit që u rrit me 13.6 për qind, duke nxitur aktivitete në ndërtimtari dhe industri përpunuese, ndërsa shërbimet financiare u zgjeruan përkrah kërkesës në rritje.

Kërkesa e fortë e brendshme gjithashtu nxiti rritjen e importeve, të cilat u rritën me 14.5 për qind në pesë muajt e parë të vitit, duke tejkaluar një rritje prej 12-përqindësh të eksporteve. “Dërgesat nga diaspora dhe investimet e huaja direkte dhanë vetëm mbështetje të kufizuar, duke shënuar rritje përkatësisht prej



3.5-përqindësh dhe 3.6 për qind deri në maj”, thuhet tutje. Kërkesa e lartë e brendshme, përfshirë rritjen e konsumit të qeverisë, së bashku me çmimet në rritje të ushqimeve, pijeve, energjisë elektrike dhe shërbimeve, nxiti inflacionin në gjysmën e parë të vitit 2025. “Inflacioni i konsumatorit arriti në 4.3 për qind në korrik 2025, duke e çuar mesataren për periudhën janar-korrik në

3 për qind. Edhe inflacioni bazë u rrit gjatë kësaj periudhe, duke arritur një mesatare prej 1.5-përqindësh deri në korrik 2025”, thuhet në raportin e BB-së.

Rreziqet fiskale dhe ato në sektorin financiar mbeten të kufizuara, duke ofruar një sfond të qëndrueshëm për ekonominë, pavarësisht prej ngadalësimit të rritjes. Pozicioni fiskal vazhdon të

mbështetet nga taksat e forta mbi shpenzimet aktuale, së bashku me ekzekutimin më të lartë të investimeve publike, të cilat priten ta mbajnë deficitin fiskal rreth 1 për qind të PBB-së midis viteve 2026 dhe 2027. Një pjesë e raportit e Bankës Botërore ka të bëjë edhe me perspektivën dhe pasigurinë. “Vonesat në formimin e një qeverie të re mund ta ngadalësojnë zbatimin e agjendës së reformave strukturore dhe të vonojnë aksesin në financim të jashtëm, përfshirë Planin e ri të Rritjes së BE-së”, thuhet tutje.

Raporti thekson se emigrimi i vazhdueshëm është pengesë për rritjen, ndërsa potenciali i pashfrytëzuar vendas, veçanërisht i grave, mund të zhblokohej duke rritur pjesëmarrjen e grave në fuqinë punëtore.

QEVERIA NDAN 8.9 MILIONË EURO PËR 198 NDËRMARRJE MIKRO, TË VOGLA DHE TË MESME

EPOKA E RE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 8 TETOR - Kryeministri në detyrë, Albin Kurti, së bashku me ministren në detyrë të Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, Rozeta Hajdari, morën pjesë në ceremoninë e nënshkrimit të marrëveshjeve për mbështetjen financiare të 198 ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme, të cilat janë përzgjedhur përfituese të mbështetjes financiare në vlerë 8.9 milionë euro nga Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë përmes Agjencisë për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë (KIESA).

Duke shprehur kënaqësinë e veçantë që ndodhet në mesin e atyre bizneseve, kryeministri tha



se “në përputhje me vizionin tonë për qeverisje të mirë, zhvillim të qëndrueshëm, mirëqenie, siguri dhe barazi, krijimi i një mjedisi të favorshëm të të bërit biznes dhe rritja e konkurrueshmërisë së ndërmarrjeve tona, mbeten prioritetet të pandryshuara”. “Me këtë investim të radhës ne po

ofrojmë mbështetje direkte për shpалosjen e potencialit dhe rritjen e industrisë vendore. Pra, pikërisht për ata që janë kontribuues kyç të zhvillimit të mëtutjeshëm ekonomik, social dhe mjedisor në vendin tonë”, tha kryeministri.

198 ndërmarrje mikro, të vogla dhe të mesme janë përfituese

nga tri skema të granteve nga KIESA: Skema e granteve për mbështetje ndërmarrjeve prodhuese me potencial për eksport, për blerjen e makinerive prodhuese, nga e cila janë 129 ndërmarrje përfituese me vlerë financiare prej 7.3 milionë eurosh; Skema e granteve në mbështetje të ndërmarrjeve që operojnë në sektorin e TIK-ut, nga e cila kanë përfituar 42 ndërmarrje, me vlerë prej 1 milion eurosh; dhe Skema e granteve për certifikimin e produkteve, me gjithsej 27 biznese përfituese, në vlerë prej 600 mijë eurosh. “Nënshkrimi i këtyre marrëveshjeve është shembull i qartë i përkushtimit për ta mbështetur industrinë dhe për të krijuar mundësi të reja në një klimë biznesi adaptues dhe konkurrues në Kosovë. E

nganjëherë sektori i industrisë nuk kuptohet mjaftueshëm që shtysë kryesore nuk e ka thjesht profitin, por zgjerimin. E neve na leverdisë shumë zgjerimi i industrive tuaja, sepse sa më shumë që zgjerohen industritë tuaja, aq më shumë zëvendësohen importet, rriten eksportet dhe rritet ekonomia e vendit tonë”, u shpreh Kurti gjatë kësaj ceremonie.

Ndërkaq ministrja në detyrë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, Rozeta Hajdari, tha se po shënojmë një sukses të radhës për ekonominë tonë, për mirëqenien e qytetarëve tanë në krah me industrinë vendore. Ajo shtoi se nënshkrimi i këtyre marrëveshjeve kontribuon në mënyrë më efektive në zhvillimin e përgjithshëm të vendit tonë.

KEDS-i po dyfishon kapacitetet e rrjetit në Prishtinën e Re

PRISHTINË, 8 TETOR - Transformimi i madh i rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike në Prishtinë ka hyrë në një fazë të re vendimtare. Të mërkurën është bërë konvertimi i Daljes Veterniku 1 nga 10 kV në 20 kV, duke përfshirë mbi 20 trafostacione të saj.

KEDS-i ka theksuar se ky është një hap i rëndësishëm në kuadër të projektit të madh të konvertimit të Nënstacioneve Prishtina 6 dhe Prishtina 7 dhe krijimit të unazave ndërmjet tyre, që tashmë është

përfunduar me sukses. “Ky sistem i ri i unazave nënkupton se rrjeti i tensionit të mesëm në kryeqytet do të ketë alternativa furnizimi. Pra, nëse ndodh një prishje, konsumatorët nuk do të mbeten pa energji elektrike, por do të furnizohen përmes daljeve alternative. Ky është një standard i avancuar i sigurisë dhe qëndrueshmërisë së furnizimit, që deri më tani ka munguar në shumë zona të Prishtinës”, ka njoftuar KEDS-i.

Më tej në njoftim theksohet se

para dhjetorit gjithçka parashihet të jetë e gatshme në komplet pjesën jugore të Prishtinës, duke përfshirë edhe një prej qendrave më të rëndësishme të vendit - QKUK-në. “Spitali kryesor i Kosovës tashmë është i mbrojtur me tri lidhje alternative dhe konvertimi i Daljes nga 10kV në 20kV është bërë gjatë fundjavës së kaluar. Kjo garanton stabilitet maksimal për furnizimin me energji, sidomos në situata të mbingarkesave. Ky projekt sjell një dyfishim të kapaciteteve të

furnizimit për Prishtinën e re, që përfshin gjithë jugun e kryeqytetit me rreth 20 Dalje të tensionit të mesëm. Përfitimet janë të drejtpërdrejta: një rrjet më i fuqishëm, më i besueshëm, më i sigurt dhe i përgatitur për nevojat në rritje të qytetit”, thuhet në njoftim, duke shtuar se konvertimi i rrjetit nga 10kV në 20kV nuk është thjesht një modernizim teknik - është një hap drejt përputhjes me standardet evropiane të shpërndarjes së energjisë, duke i siguruar Prishtinës jo vetëm kapacitete



të dyfishuara, por edhe një nivel krejt tjetër të cilësisë së shërbimit. “Nga Veterniku, që tashmë është shembull i këtij transformimi, e deri te çdo lagje e jugut të kryeqytetit, ky projekt shënon një kthesë historike në rrugën e modernizimit të energjisë elektrike në Kosovë”, ka njoftuar KEDS-i.

MAXIMILIANI, PERANDORI I MEKSIKËS: NJË VIZITË ZHGËNJYESE NË DURRËS (1867)

Ferdinand Maximilian Joseph, Arqiduka i Austrisë (1832–1867), ishte vëllai më i vogël i Perandorit austriak Franz Joseph. Ai kishte një interes të veçantë për udhëtimet. Në vitin 1854, në moshën 22-vjeçare, Maximiliani u emërua komandant i përgjithshëm i Marinës austro-hungareze. Dhjetë vjet më vonë, me mbështetjen e Francës, ai u shpall Perandor i Meksikës (1864–1867), por me ngritjen e forcave republikane nën udhëheqjen e Benito Juárezit, ai u arrestua dhe u ekzekutua. Në veprën e tij me shtatë vëllime në gjuhën gjermane, të titulluar Nga jeta ime: Skica udhëtimesh, aforizma dhe poezi (1867), Maksimiliani botoi një rrëfim prej 170 faqesh për një udhëtim përgjatë bregdetit të Shqipërisë, gjatë të cilit ai shkoi për gjah në Rodon. Kjo vepër përfshin një përshkrim interesant të Durrësit, i cili në atë kohë vuante nën sundimin osman dhe nuk e la aspak të impresionuar autorin.

Nga: Maximiliani I i
MEKSIKËS[1]

*Përktheu në anglisht (nga
gjermanishtja): Robert Elsie
Përkthimi në shqip (nga
anglishtja): Telegrafi.com*

Udhëtuam gjithë natën dhe ditën tjetër kaluam Kepin e Palit, ndërkaq pasditen e ditës tjetër lundruam pranë grykëderdhjes së gjatë me rërë të Shën Luçisë, që shtrihet në det dhe formon një pengesë mbrojtëse për Durrësin. Pastaj vazhduam në drejtim të ashtuquajturës Pietra Bianka [Shkëmbi i Kavajës], një shkëmb i shndritshëm në kodrat përgjatë bregdetit, dhe u ndalëm në portin e Durrësit. Gjiri i gjerë i Durrësit formohet nga dy vargje kodrash që zgjaten në det, ku ai në Veri është i pyllëzuar teksa zbret drejt fushës. Rrëzë këtyre kodrave ndodhet Durrësi, i pozicionuar mes fushës dhe kepit, pikërisht pranë portit. Ndërtesat më të largëta të qytetit ngjiten mbi vetë shpatin. Në këtë kohë, është një grupë e trishtuar, e rrethuar me mure të rrënuara dhe parapete të shembura. Në këtë qytet të vogël duket një minare e plotë dhe një tjetër e dëmtuar pjesërisht. Më lart në kodër ndodhet një grumbull rrënojash pallatesh ose kazermash. Njëra prej dy portave të qytetit përballet me portin dhe me një zyrë doganore e cila përbëhet nga një kasolle druri - edhe kjo natyrisht në gjendje të rrënuar. Nëse dëshironi t'i afroheni Durrësit nga deti dhe të ngjiteni mbi të ashtuquajturin quai [platformë zbarkimi], do t'ju këshilloja me ngulm të merrni një sigurim jete në Londër - nëse anglezët

dashamirës ndaj përfitimit do të pranenin ndonjëherë të siguronin udhëtarët drejt Durrësit. Është një veprim i tmerrshëm të shkelësh shpejtë mbi dërrasat e kalbura ndërsa kalon përmes trungjeve të skelës për të arritur në tokë. Pikërisht pranë këtij të ashtuquajturit quai, mes detit dhe zyrës doganore, ndodhet një rrap i mrekullueshëm dhe i vjetër i cili, ashtu si minarja, është simboli i çdo qyteti të vërtetë osman.

Në të djathtë të qytetit shtrihet një zonë e rrafshët, e rrethuar nga kodrat që ngrihen gjithnjë e më lart. Ky vargmal piktoresk, i pasur me shkëmbinj dhe pyje, nën të cilët ndodhen fushat dhe livadhet, formon horizontin jugor teksa shtrihet drejt detit. Aty, në mjegullën kaltër, mund të shihet kulla e Guerin Meskinos, heroit të dashur i marinarëve tanë, aventurat e të cilit lexohen në të gjitha anijet tona. Gjiri është shumë i madh ose qyteti shumë i vogël për ta cilësuar tërësinë si tërheqëse apo interesante, megjithëse nuk mungon karakteri. Zona e sheshtë që përmenda më sipër është në të vërtetë një sipërfaqe e madhe me ujë të ndenjur, e cila dikur e kishte bërë kepin dhe qytetin një ishull dhe ua mundësonte galerave greke dhe romake të hynin në port nga gjiri prapa qytetit, në Veri. Por, tani kjo masë uji është ndërprerë nga disa brigje ranore. Ne e dërguam një kadet në qytetin e zymtë për të njoftuar përfaqësuesin konsullor për mbërritjen tonë. Ai u kthye shpejt dhe vuri gjithë anijen në një gjendje rrëmuje me raportin që solli nga vizita e tij në konsullatë. Duhet pasur parasysh se djali i ri e i thjeshtë sapo kishte qenë në Rodon dhe tani na fliste për një sallon të gjerë, një divan të stolisur me pasuri, aparatura të pasura orientale për temjan dhe vajzën jashtëzakonisht të bukur të konsullit, të zbukuruar me brokadë floriri dhe diamante, “një zonjë me hijeshi të pakrahasueshme, një perlë e rrallë”. Pas përshtypjes së tmerrshme që na kishte lënë ky qytet i vogël, kjo ishte si një hosana. E rimorëm guximin dhe në fakt u emocionuam mjaft me afrimin e barkës së vogël. Në të mbërriti Padre Negri dhe, në shoqërinë e tij, ishte babai fatlum i vajzës së pakrahasueshme, si edhe xhaxhai i tij i nderuar, megjithëse tashmë i moshuar - konsulli i nderit, 86-vjeçari Tedeschini. Babai fatlum ishte gjithashtu tregtari më i pasur në Durrës, një njeri i këndshëm dhe patriarkal, që kishte shërbyer si në Kishë, ashtu edhe në administratë, dhe



që na dha një mbështetje të madhe gjatë qëndrimit tonë, duke na përmbytur me mirësi. Ky konsull nderi, tashmë në pension, kishte një mendje të kthjellët dhe, gjatë viteve të gjata këtu, kishte studiuar dhe njohur vendin, zakonet dhe virtytet e tij. Kishte gjithashtu një sens humorit, ndaj ishte shoqëri njëkohësisht e këndshme dhe e dobishme. Ai erdhi në bordin e anijes i veshur me rroba gjahu, pak a shumë siç e përfytyroj një rojtar pyjesh në teatër. Një fustanellë e gjatë e zezë me përparëse gjahu në ngjyrë të gjelbër dhe të artë, varej lirshëm rreth kofshëve të tij të lashta. Koka e tij plot shkëlqim, në pjesën e pasme të së cilës njeriu instinktivisht kërkonte një bishtalec, ishte mbuluar me një kapelë të thjeshtë gjahu, me një strehë të madhe për t'u mbrojtur nga dielli dhe shiu.

Atë mbrëmje zbrita në tokë bashkë me vëllezërit e nderuar Tedeschini. Sapo kishim kaluar mbi molin e rrezikshëm, kur u rrethuam nga turma të rrëmujshme rrugaçësh. Mes tyre ishte një lloj komandanti fortese, i veshur - me autoritetin e një rreshteri - me uniformë të grisur dhe të përdorur, si dhe me stafin e tij akoma më të zhubravitur dhe më të etur për bakshish sesa vetë ai. Ishte një hordhi shitësish alkooli, të rinj pothuajse të zhveshur, qytetarë dhe fshatarë të mbuluar nga papastërtia, e megjithatë të veshur me kostume shumëngjyrëshe, hamallë, si dhe ciganë të zinj si qymyri, të të gjitha moshave, të veshur me lecka - figura të vërteta të nëntokës. Në degët e rrapeve, nën kupolën e artë të gjetheve nëpër të cilën kaluam për të arritur te porta e qytetit, dëgjoheshin turtullët - mysafirë të hareshëm dhe të gjallë që konsulli ynë i nderit i kishte

sjellë në Durrës. Rojet e habitura të fortesës rrinin përreth portës, në anët e së cilës shtriheshin kolona prej graniti, mbetje nga lavdia e dikurshme e qytetit. Zot i madh, çfarë figurash! Një grusht sakatësh, të veshur me rrecka dhe të dehur. Më vonë, nga një bisedë me konsullin e Shkodrës, i cili kishte mbërritur në një natë dhe nuk ishte lejuar të hynte, mësuam se sa e “fortifikuar” dhe e “mbrojtur” ishte kjo portë. Ai thjesht e goditi portën dhe hyri pa asnjë problem në “kryeqytetin e Shqipërisë”.

Zemra e qytetit, brenda mureve të fortesës, dukej edhe më keq. Radhë pa fund shtëpish të rrënuara dhe të ndotura, me çati që rrezikonin të shembeshin dhe me një erë aq të rëndë sa të merrte mendtë. Kjo është poezia e Orientit.

Qyteti ngjan me skenografinë e mbetur nga ndonjë balet i vjetër oriental për një treg turk, braktisur prej dekadash në bodrumin e ndonjë teatri dhe mbuluar me rrjeta merimangash, dhe më pas e nxjerrë rastësisht në dritën e zbehtë të skenës, ende e mbuluar me pluhur dhe rrjeta. Nëse kësaj tabloje i shtoni disa figurantë të pensionuar dhe aktorë të moshuar, të veshur me kostume të blera në tregje të rrobave të përdorura dhe që kutërbojnë kolofon dhe blozë llambash të fikura, mund ta përfytyroni se si dukej Durrësi. Të gjitha qytetet e Orientit duken më shumë a më pak kështu - madje edhe Kajro dhe Izmiri - por, këto të fundit janë të mëdha dhe plot gjallëri dhe, në vend të leckave, gjen brokadë floriri dhe shalle indiane.

Megjithatë, natyra e ka shtuar poezinë dhe romantizmin e vet, sepse një xhami dhe një minare - edhe pse të vogla dhe të rrënuara

si këtu në Durrës - janë pamje që nuk harrohen. Edhe nëse çatitë e pazarit shemben, ato shpejt mbulohen me hardhi dhe rrush të artë, të cilët, si zinxhirë, i mbajnë strukturat që të mos shemben fare.

Edhe pse popullsia është e vogël, has ende figura të moçme turke, me çallma të mëdha dhe mjekra të gjata, të cilët, me kamish dhe kafë në dorë, ulen nëpër stalla pazari dhe, me fatalizmin mysliman, presin ndonjë blerës - pa as më të voglën lëvizje apo gjest miqësor që do ta inkurajonte dikë të blinte diçka.

Era e rëndë që endet mes shtëpive dhe pallateve, nëpër rrugë dhe sheshe në gjithë Orientin, është më e pranishme këtu ... Duke u përplasur mbi grumbuj plehrash dhe mbeturinash, arrita te porta e dytë e Durrësit, ku disa roje fshatarake supozohej se kujdeseshin për sigurinë dhe mirëqenien e qytetarëve. Menjëherë pas portës ndodhet një varrezë me formë të çrregullt, ku mund të shihje bazamentet e disa kolonave të lashta prej graniti. Ciganët jetojnë nëpër kopshtet aty pranë dhe, në këmbët e mureve buzë detit, shtrihet një moçal që shkon deri në laguna - vendi i lojës për çafkat e mëdha të bardha. Bëra një banjë të shkurtër në muzg dhe u ktheva në anije, jo edhe aq i mahnitur nga mrekullitë e këtij metropoli orientale. /Telegrafi/

[1] Pjesë nga: Ein Stück Albanien. në: Aus meinem Leben: Reiseskizzen, Aphorismen, Gedichte von Maximilian, Kaiser von Mexiko (Leipzig: Duncker & Humblot 1867), vëll. 4, fq. 143-149. Përkthyer nga gjermanishtja nga Robert Elsie.

HISTORIA E NJË GJYQI QË PO TRONDIT EUROPËN: PASANIKJA RRËMBEU FËMIJËT E SAJ ME NDIHMËN E SPIUNËVE IZRAELITË



Në Gjermani ka nisur procesi gjyqësor ndaj Christina Block, një trashëgimtare e pasur që akuzohet se ka rrëmbyer fëmijët e saj. Historia ka tronditur opinionin publik jo vetëm në Gjermani, por në mbarë Europën. Por për çfarë bëhet fjalë? ‘Guardian’ sjell një shpjegim për procesin që po mban mbërthyer mediat dhe opinionin publik.

Prej më shumë se gjysmë shekulli, ‘Block House’ ka qenë një nga zinxhirët e restoranteve më të njohur në rrugët kryesore të Gjermanisë – një koleksion miqësor për familjet, ku ndër specialitetet më të njohura janë “hamburgeri klasik Block” dhe “filet mignon”.

Por prej muajsh, zinxhiri me bazë në Hamburg po bën bujë për një arsye krejt tjetër: një betejë e ashpër dhe e pazakontë për kujdestarinë mes trashëgimtares së biznesit familjar, Christina Block, dhe ish-bashkëshortit të saj, për dy më të vegjlit nga katër fëmijët e tyre.

Mes atyre që akuzohen se janë përfshirë në këtë çështje janë spiunë izraelitë, si edhe ish-shefi i shërbimit të inteligjencës së brendshme të Gjermanisë.

Tani, përplasja, e cila deri tani ishte zhvilluar kryesisht në zyrat e avokatëve dhe në shtypin tabloid të vendit – diçka e

pazakontë për Gjermaninë kjo, ku ekzistojnë ligje shumë të rrepta për privatësinë - ka mbërritur në një gjykatë të Hamburgut.

Mes një buje të madhe mediatike, Block po gjykohet në gjykatën rajonale të qytetit portual në veri, e akuzuar për rrëmbim të të fëmijëve, lëndim të rëndë trupor dhe ndalim të paligjshëm. Më saktë, dhe në qendër të çështjes, është akuza se ajo ka kontraktuar një kompani ndërkombëtare sigurie për të kryer rrëmbimin e dhunshëm dhe ndërkufitar të dy fëmijëve të saj më të vegjël. Nëse shpallet fajtorë, ajo rrezikon deri në 10 vjet burg.

Në bankën e të akuzuarve së bashku me të ndodhet Gerhard Delling, ish-gazetar sportiv televiziv, një nga prezantuesit më të njohur të futbollit në Gjermani dhe partneri romantik i Block që nga viti 2021. Ai akuzohet për ndihmë dhe bashkëpunim në operacionin e supozuar të rrëmbimit.

Çështja po shqyrtohet në një sallë gjyqi me siguri të lartë, zakonisht e rezervuar për gjyqe kundër terroristëve, për shkak të natyrës së të akuzuarve, mes të cilëve përfshihen ish-agjentë të supozuar të inteligjencës izraelite. Sipas akuzave, Block dyshohet se ka kontraktuar një grup për të sulmuar ish-bashkëshortin e saj,

Stephan Hensel, dhe dy fëmijët e tyre më të vegjël, atëherë 10 dhe 13 vjeç, ndërsa po shikonin një shfaqje fishekzjarrësh si pjesë e festimeve të Vitit të Ri 2023-24 në shtëpinë e Hensel në Danimarkën jugore, pranë kufirit me Gjermaninë.

Mësohet se personat e sulmuar Hensel, para se të tërhiqnin djalin dhe vajzën e tij në një pyll, përmes një lumi dhe në një makinë. Fëmijëve u mbyllën gojën me shirit dhe njërin prej tyre e lidhën. Ata u kërcënuan me vdekje, ndërsa një nga burrat u tha: “Qetësohuni, përndryshe ju vrasim”.

Policia daneze me qen gjurmues iu vu pas rrëmbyesve, për shkak të një alarmi që ishte vendosur nga babai mbi djalin e tij.

Fëmijët u çuan në një fermë në Baden-Württemberg, në jug të Gjermanisë, dhe u mbajtën aty deri sa Block mbërriti për t’i marrë më 2 janar 2024 dhe i dërgoi në vilën e saj në Hamburg. Disa ditë më vonë, ata u dorëzuan tek policia dhe u kthyen në Danimarkë.

Si Block, ashtu edhe Delling – i akuzuar për ndihmë në organizimin e dorëzimit dhe transportimin e fëmijëve drejt Hamburgut – mohojnë të gjitha akuzat.

Mes disa bashkëpunëtorëve të dyshuar është edhe August Hanning, ish-shefi i shërbimit

federal të inteligjencës të Gjermanisë, BND, i cili sipas prokurorëve ka ndërmjetësuar kontaktin e parë mes Block dhe kompanisë izraelite të spiunazhit, e supozuar si kryesore në rrëmbim. Hanning, i cili ka folur publikisht në mbrojtje të Block, mohon çdo përfshirje në rrëmbim.

Block ka thënë se kompania e sigurisë veprimi me iniciativën e vet, dhe se nëna e saj, e cila vdiq rreth nëntë muaj para rrëmbimit, pagoi për operacionin, i cili besohet se ka kushtuar qindra mijëra euro dhe është planifikuar për muaj të tërë.

Block akuzohet gjithashtu se ka kontraktuar të njëjtën kompani për të vendosur imazhe të rreme të abuzimit seksual ndaj fëmijëve në pronën e Hensel, në një përpjekje për ta akuzuar atë si abuzues fëmijësh. Ajo mohon edhe këtë akuzë.

Ekipi mbrojtës i Block pritet të argumentojë se ajo u dëshpërua pasi fëmijët e saj u mbajtën padrejtësisht nga babai në Danimarkë, kur ai refuzoi t’i kthente sipas marrëveshjes pas një vizite të planifikuar më parë në vitin 2021.

Avokatët e saj thonë se ajo kishte marrë kujdestarinë e fëmijëve, por Hensel kishte injoruar vendimin gjerman. Policia gjermane kishte kthyer fëmijët në Danimarkë pas rrëmbimit, në

kërkesë të policisë daneze. Autoritetet daneze kanë refuzuar të pranojnë vendimin gjerman për kujdestarinë. Mediat gjermane kanë raportuar gjerësisht se autoritetet daneze kanë thënë se fëmijët nuk duan të kenë asnjë kontakt me nënën e tyre.

Hensel ka marrë kujdestarinë e dy fëmijëve nga një gjykatë daneze, një vendim që Block ka provuar, por ka dështuar, ta anulojë në gjykatat gjermane. Tani ata jetojnë me babanë e tyre në Danimarkë në një adresë sekrete, dhe thuhet se të gjithë kanë ndryshuar emrat e tyre.

Ky proces gjyqësor me profil të lartë pritet të vazhdojë deri në Krishtlindje dhe do të dëgjojë 141 dëshmitarë dhe 22 ekspertë. Gjatë dy ditëve të para të seancës, Block dhe Hensel ulën vetëm disa metra larg njëri-tjetrit, por asnjëri nuk e pa ose foli me tjetrin.

Vajza e tyre, tani 14 vjeç, ka thënë se dëshiron të flasë në gjykatë.

Themeluesi dhe patriarku i biznesit ‘Block House’, Eugen Block, 83 vjeç, i cili u dëshiron vizitorëve “much joie de vivre and pleasure” në meny të restoranteve të tij, ka thënë se nuk i ka parë nipërit dhe mbesat e tij prej vitesh. Beteja për kujdestarinë i ka shkaktuar atij “shumë dhimbje zemre”, tha ai për Hamburger Abendblatt.



Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

Vetëm 5 000 tifozë në ndeshjen në mes të Serbisë dhe Shqipërisë

PRISHTINË, 8 TETOR - Frika e madhe dhe rrezikshmëria e lartë kanë bërë që organizatori i ndeshjes Serbi - Shqipëri ta shkurttojë edhe më tej numrin e tifozëve që do të jenë të pranishëm më 11 tetor në stadiumin e Leskovcit. Federata e Futbollit e Serbisë

duket se nuk do të lejojë më shumë se 5 000 mijë tifozë në stadiumin “Dubaçiq”, që është konfirmuar edhe nga selektori Dragan Stojković. Javën e shkuar FIFA ka dënuar Federatën e Serbisë, duke ia mbyllur 20 për qind të kapacitetit të stadiumit, ku

pritej të lejoheshin vetëm 6 500 shikues. Megjithatë, Stojković ka pranuar se në tribuna do të ketë edhe më pak njerëz, duke u përgjigjur me fjalët se “do ta shikoni se nuk do të ketë më shumë se 5 000 tifozë”. Përkundër kësaj, masat e sigurisë pritet të jenë

të larta dhe Serbia do të jetë nën vëzhgim të FIFA-s dhe UEFA-s, të cilat thuhet se kanë paralajmëruar Federatën e Serbisë me përjashtim nga eliminoret e Botërorit nëse në ndeshjen me Shqipërinë ndodh ndonjë skandal. Krahas përjashtimit nga ky cikël




eliminators, Serbia rrezikohet edhe me një pezullim dyvjeçar.

KOSOVA DEKORON PRESIDENTIN E FIFA-S ME MEDALJE NDERI

PRISHTINË, 8 TETOR - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, e ka dekoruar të mërkurën presidentin e Federatës Botërore të Futbollit (FIFA), Gianni Infantino, me medalje nderi, për kontributin në avancimin e rrugës së futbollistëve të Kosovës në skenën ndërkombëtare.

Në ceremoninë e ndarjes së çmimit në Prishtinë, Osmani ka thënë se loja e futbollit e ka mbajtur të gjallë shpirtin e shumë fëmijëve qysh prej kohës së luftës në Kosovë më 1999. “Nën udhëheqjen tuaj, FIFA është bërë familje me shumë kombe. Kjo për Kosovën ka pasur rëndësi jetike. Ju u keni ndihmuar lojtarëve tanë që ta bartin flamurin tonë duke garuar me krenari në skenat ndërkombëtare”, ka thënë Osmani. Presidentja e ka përshkruar Infantinon si “mik të vërtetë të



futbollit” dhe “mik të vërtetë të Kosovës”. Infantino ka thënë se është i nderuar me medaljen dhe e ka përmendur se prej kur është ngjitur të krye të FIFA-s, e ka pasur të qartë se Kosova do të duhej të pranohej në organizatë për shkak të përkushtimit që kishte treguar vendi ndër vite. “Futbolli i bashkon popujt, e bashkon vendin dhe e

bën pjesë të një lëvizjeje në Evropë, dhe i bën vajzat dhe djemtë të ëndërrojnë dhe shpresojnë në të ardhmen e tyre”, ka thënë Infantino. Ai e ka ftuar në skenë ekipin e Kombëtares së Kosovës dhe i ka ftuar të gjithë që të besojnë dhe investojnë në djemtë e ekipit. Përgjatë ceremonisë, si Osmani

ashtu edhe Infantino e kanë përmendur punën e madhe që ka bërë ish-futbollisti i ndjerë, Fadil Vokrri, në kapacitetin e kryetarit të Federatës së Futbollit të Kosovës, për ta avancuar rrugën e futbollit të lojtarëve të Kosovës në skenat botërore.

Gianni Infantino po e viziton Kosovën për herë të dytë pas vizitës së tij të parë në shtator 2022, kur ishte takuar me krerët e shtetit, presidenten Vjosa Osmani dhe kryeministrin Albin Kurti. Kosova është pranuar në FIFA vetëm pak muaj pasi Infantino ishte zgjedhur për herë të parë president i saj në fillim të vitit 2016. Prej pranimi në organin qeverisës së futbollit botëror, Federata e Futbollit e Kosovës pranon ndihmë financiare prej saj çdo vit përmes programeve për ndërtimin e infrastrukturës, zhvillimin e

futbollit të grave, akademitë e të rinjve dhe ngritjen e standardeve profesionale.

Nëntë vjet pas pranimi në FIFA, Kosova është ende në kërkim të kualifikimit për një garë të madhe ndërkombëtare, siç është Kupa e Botës apo Kampionati Evropian. Ajo tani po lufton për një vend në Kupën e Botës 2026 që zhvillohet në Kanada, Meksikë dhe Shtetet e Bashkuara dhe do të përballet me Slloveninë në kualifikime të premtën, dy ditë pas vizitës së Infantinos. Kosova është në vendin e dytë në Grupin B kualifikues me tri pikë pas dy ndeshjeve, prapa lideres, Zvicrës, që i ka gjashtë. Suedia dhe Sllovenia janë në dy vendet e fundit me nga një pikë secila. Fituesi i grupit shkon direkt në Botërorin 2026, ndërsa vendi i dytë luan në play-off.

AGIM ADEMI ZGJEDHET ANËTAR I KOMITETIT PËR MARRËDHËNIE INSTITUCIONALE TË FIFA-S

PRISHTINË, 8 TETOR - Presidenti i Federatës së Futbollit të Kosovës, Agim Ademi, është zgjedhur anëtar i Komitetit për Marrëdhënie Institucionale të FIFA-s, një prej komiteteve më të rëndësishme të kësaj organizate globale. Ky emërim përfaqëson një sukses të madh për futbollin e Kosovës dhe është një njohje ndërkombëtare e kontributit të vazhdueshëm të presidentit Ademi në zhvillimin dhe avancimin e futbollit jo vetëm në Kosovë, por edhe në skenën ndërkombëtare.

Komiteti për Marrëdhënie Institucionale ka një rol kyç brenda strukturave të FIFA-s. Ai këshillon dhe ndihmon FIFA-n në ndërtimin dhe ruajtjen e marrëdhënieve me institucionet më të larta ndërkombëtare, si: Komitetin Olimpik Ndërkombëtar (IOC), Kombet e Bashkuara (OKB) dhe agjencitë e saj si UNESCO e UNICEF, organizatat qeveritare dhe joqeveritare në mbarë botën, si dhe shoqata të tjera ndërkombëtare të sportit. Përmes këtij komiteti, FIFA ndërton ura



bashkëpunimi për t'i promovuar vlerat e futbollit, si: përfshirja, barazia, paqja dhe zhvillimi i qëndrueshëm nëpërmjet sportit. Përzgjedhja e presidentit Agim Ademi si anëtar i këtij komiteti është një dëshmi e rritjes së peshës

së Kosovës në futbollin ndërkombëtar dhe një hap përpara drejt integritetit dhe diplomacisë sportive të mëtejshme të institucioneve të sportit të Kosovës në strukturat më të larta botërore. Pas zgjedhjes në këtë komitet, presidenti Ademi ka deklaruar se ky emërim është një nder dhe përgjegjësi e madhe për të personalisht, por edhe për FFK-në si institucion. “Jam i nderuar që do të kontribuoj në një komitet kaq të rëndësishëm të FIFA-s. Ky është një sukses për gjithë futbollin e

Kosovës dhe një dëshmi se puna jonë po vlerësohet në nivelet më të larta ndërkombëtare”, ka thënë Ademi.

Ky rol i ri i presidentit të FFK-së pritet ta forcojë më tej pozicionin e Kosovës në arenën ndërkombëtare dhe të sjellë mundësi të reja për bashkëpunime dhe projekte zhvillimore në të ardhmen. Rikujtojmë se presidenti Ademi është edhe anëtar i Komitetit HatTrick të UEFA-s që, po ashtu, është një prej organeve më të rëndësishme të UEFA-s.

Ronaldo, futbollisti i parë miliarder në botë

Riad, 8 tetor - Cristiano Ronaldo është bërë futbollisti i parë miliarder në botë. Për ta bërë publike këtë arritje ka menduar “Bloomberg”, ku në bazë të përlloraritjeve të aseteve dhe pasurisë së futbollit të Al Nassrit, pasuria e CR7 ka kapur shifrën e

1.4 miliard dollarëve. Kjo është një arritje e pabesueshme për një futbollist, me Ronaldon që vendos në këtë mënyrë një tjetër rekord unik, këtë herë jashtë fushës së blertë. Ndryshe nga çdo futbollist tjetër, Ronaldo ka menaxhuar në mënyrë të

shkëlqyer imazhin e tij duke firmosur kontrata miliona euro me sponsor si “Armani”, “Nike” etj. Në këtë pasuri marramendëse përcaktuese ka qenë edhe kontrata e tij e fundit e firmosur me klubin Al Nassr, shkruan Balkanweb. Jo vetëm 400

milione dollarë të ardhura nga rinovimi i kontratës, por CR7 ka marrë edhe një pjesë të aksioneve të klubit saudit. Në këtë mënyrë, Ronaldo ka arritur të kalojë i pari limitin, duke u shndërruar në futbollistin e parë dhe të vetëm miliarder.





Kompania Regjionale e Mbeturinave “Ambianti” Sh.A. Pejë
Me adresë Rr.Xhem Sadrija pn ,Fusha e Pejës-Tranzit KK Pejë

Bazuar ne ligjin e Punës: LIGJI Nr. 03/L-212 sipas neni 8,dhe në bazë të Udhëzimit Administrativ MFPT- NR 01/2024, Kryeshefi Egzekutiv i Kompanis Regjionale të Mbeturinave “Ambianti” Sh . A .Pejë me datë 09.10.2025, shpall konkurs të jashtëm për këto vende të punës :

KONKURS

Pozita : Sigurim i Objektiv (Roje) - 1 pozitë

Vendi punës : Pejë
Kohëzgjatja e periudhës provuese është 6 muaj me mundësi vazhdimi sipas kontratave të ligjit të punës.
Koefficienti i pagës : 1.8

Përshkrimi i detyrave dhe përgjegjësi të punës:

- Përcjellë hyrje-daljen e palëve, punëtorëve dhe automjeteve.
- Daljen e punëtorëve pa leje paraprake, të parakohshme i evidenton në libër të veçantë.
- Palëve u jep fletë-hyrjen dhe i orienton për në shërbimet për të cilat janë të interesuara.
- Është i obliguar për sjellje korrekte me palët dhe për qëndrim në vendin e tij të punës.
- Bënë sigurimin e objektivit në të cilin është përcaktuar në bazë të planit mujor.
- Bënë shiqimin e gjendjes së objektivit dhe mjeteve kundër zjarrit dhe rregullësis së tyre.
- Kontrollon dhe largon personat e paautorizuar dhe të dyshimt që ndodhen afër objektivit.
- Ndërmerr masat e nevojshme në mbrojtjen e objektivit nga dukurit natyrore dhe për këtë lajmëron menjëherë shërbimet e specializuara.
- Pranon dhe dorëzon ndërrimin dhe për gjendjen e objektivit e informon punëtorin e sigurimit të radhës.
- Obligohet që në vendin e punës të mbajë uniformën.
- Pas orarit të rregullt të punës nuk guxon t'i lejoj hyrjen e personave të pautorizuar, përveç zyrtarëve të lartë të ndërmarrjes.
- Është përgjegjës i përgjithshëm i materialit dhe automjeteve, gjatë kohës së orarit të punës, me rastin e marrjes dhe dorëzimit të detyrës.
- Ndalon personat dhe automjetet e pa autorizuar dhe ndalon huthjen e mbeturinave nga ana e popullatës lokale.
- Të kryej punë të cilat i besohen mbrenda ditës, të ketë kujdesë në punë në mënyrë që mos të vjen gjerë te ndezja e mbeturinave.
- Në rast të ndonjë avarie, ta evitojë atë dhe të lajmëroj shefin e sigurimit dhe organet Kompetente;
 - Ndihma e shpejtë – 194,
 - Emergjenca Civile – 112,
 - Zjarrfikësit – 193,
 - Policia – 119.
- Të punojë të shtunave dhe të dielave.
- Kryen pune bazuar në kontratën e punës, por edhe punë tjera me urdhëresë të shefit të sigurimit.
- Për mosrespektimin e pikave të lartcekura i përgjigjet drejtpërdrejt Kryeshefit Ekzekutiv.

a. Kushtet e përgjithshme :

- CV;
- Çertifikatë që kandidati nuk është nën hetime;
- Letër motivimi;
- Kopja e letërnjoftimit;
- Çertifikatë mbi gjendjen shëndetësore.

b. Kushtet e veçanta : (kualifikimet profesionale)

- Shkollimin fillor përparësi shkollimi i mesëm;
- Përparësi janë çertifikimet në siguri
- Aftësi shumë të mira organizative
- Njohja e punës me kompjuter.
- Ai /Ajo duhet të jenë në gjendje të punojnë nën presion, të ketë moral të fortë për punë dhe integritet të nivelit të lartë.

Mënyra e Aplikimit : Dokumentacioni duhet të dërgohen ne e-mailit krmambientikonkurset@gmail.com

Data e për aplikim është nga 09.10.2025 deri me 24.10.2025 ora 12:00. Dokumentacioni që mbërrin pas afatit dhe i pakompletuar do të konsiderohet i pavlefshëm.. Dokumentet origjinale mund të kërkohen, sipas nevojës. Vetëm kandidatët e selektuar për listën e ngushtë do të kontaktohen.



Kuvendi Komunal
Malishevë
Drejtoria Komunale e
Arsimit

Gjimnazi “Hamdi Berisha”
Malishevë



Nr prot.: /25

Datë:09.10.2025

Mbështetur në Udhëzimin Administrativ (MASHT) Nr.02/2016 për aktivitetet jashtë shkollore, Gjimnazi “Hamdi Berisha” në Malishevë shpallë:

OFERTË PËR EKSKURSION

Gjimnazi “Hamdi Berisha” në Malishevë shpall ftesë për ofertë për zgjedhjen e agjencionit të udhëtimit për organizimin e Ekskursionit në Republikën e Shqipërisë me maurantë për vitin shkollor 2025/2026.

Kohëzgjatja e ekskursionit do të jetë 4 bujtje/ 5 ditë, me pansion të plotë. Në ekskursion do të marrin pjesë 300 nxënës.

Agjencioni duhet të plotësojë këto parakushte:

- Agjencioni duhet të jetë i licencuar,
- Të ketë bërë kontrollin teknik të autobusëve sipas procedurave ligjore
- Të ketë numer të mjaftueshëm të autobusëve për nevojat e nxënësve, do të merret parasysh edhe viti i prodhimit të autobusëve,
- Agjencioni duhet të ketë dëshmi për shëndetin fizik dhe mendorë të ngasësve të autobusëve.
- Agjencioni duhet të siguroj përkujdesje mjekësore për nxënësit dhe dëshmitë (certifikatë pune dhe diplomë të mjekut) që shoqëron nxënësit.
- Agjencioni duhet të ketë dokumentacionin (licencen) e akreditimit të ushqimeve në Shqipëri të vulosur dhe nënshkruar nga pronari i hotelit
- Kategorizimi do të bëhet në bazë të kriterëve dhe sigurisë për nxënësit, ku edhe do të vendoset për ofertën dhe vendin se ku do të vendosen nxënësit (hotelin) nga komisioni përkatës ditën e hapjes së ofertës.
- Agjencioni duhet të prezantoj menyn ditore për secilen ditë të qëndrimit në Shqipëri të vërtetuar dhe nënshkruar nga pronari i hotelit
- Kontrata në mes agjencionit dhe hotelit
- Një konfirmim të rezervimit të hotelit përkatës të vërtetuar mes kompanis dhe hotelit me datë të caktuar.
- Licenca e ballos (Vallëzimit) ku nxënësit do të argëtohen e vulosur dhe nënshkruar nga pronari i hotelit.
- Hoteli ku bëhet akoamodimi i nxënësëve duhet të ketë shërbimin e sigurimit fizik profesional.
- Vërtetimi i ATK-së
- Agjencioni duhet të ofroj listen e shoferëve dhe puntorëve të deklaruar në ATK ,që do të marrin pjesë në ekskursion.
- Agjencioni duhet të mbulojë shpenzimet e vizitave të nxënësve në monumentet historike.

Ofertat të cilat nuk i përmbushin kriteret e kërkuara nuk do të merren në shqyrtim.

Afati i aplikimit është 7 ditë nga dita e shpalljes më 09.10.2025 (ditën e ejte) Ofertat pranohen në sportelin e DKA-së në Malishevë.

Hapja e ofertave do të bëhet në ditën e fundit të aplikimit 15.10.2025 duke filluar nga ora 14:00, në shqollë.

Malishevë
09.10.2025

Gjimnazi “Hamdi Berisha” Malishevë



ROYAL CROWN

RC
cola

ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

Columbus, Georgia, USA
Since 1903

Columbus, Georgia, USA
0.5L

MEKA
®
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992

